



РЕПУБЛИКА СЕВЕРНА МАКЕДОНИЈА  
REPUBLIKA E MAQEDONISË SË VERIUT

Бр./Nr \_\_\_\_\_

\_\_\_\_\_г./в.



Në bazë të nenit 22 paragrafi 1 nga Ligji për parandalimin e korrupsionit dhe konfliktit të interesave ("Gazeta zyrtare e Republikës së Maqedonisë " Nr. 12/2019) neni 40 paragrafi 2 nga Rregullorja për punë të Komisionit Shtetërorë për Parandalimin e Korrupsionit, duke vepruar sipas denoncimit të parashtruar nga parashtrues i panjohur KSHPK (në tekstin e mëtejshëm) në seancën e 80-të, të mbajtur më 18.01.2023, morri vendimin vijues:

#### VENDIM

Denoncimi i regjistruar me numër 12-165/1 datë 17.01.2022, me pretendime për parregullsi në drejtimin e ISHP-së /// - ///, HIDHET POSHTË .

KSHPK-ja konstatoi se sipas Ligjit për Parandalimin e Korrupsionit dhe Konfliktit të Interesit nuk ka elemente për veprim kompetent për rastin në fjalë sepse pretendimet e denoncuar nuk janë korrupsion sipas përkufizimit të përcaktuar në Ligjin për Parandalimin e Korrupsionit dhe Konflikti i Interesit.

Lënda me numër 12-165/11 të datës 17.01.2022 të mbyllet dhe të arkivohet.

Vendimi i KSHPK-së, në formë të depersonalizuar, të publikohet në ueb - faqen e KSHPK-së brenda 5 (pesë) ditëve nga dita e vendimarrjes.

#### Arsyetim

Më 17 janar 2022, nga një parashtrues i panjohur është dorëzuar denoncim me pretendime për parregullsi në menaxhimin e ISHP-së /// - /// dhe është formuar lënda me numër 12-165/1 e datës 17 janar 2022.

Në denoncim, pa u treguar aktivitete të veçanta që tregojnë dyshime për veprime korruptive, renditen shkeljet disiplinore dhe shkeljet e kryera nga drejtori i institucionit, i cili ka hyrë në detyrë në vitin 2008, dhe këto tregohen si shkaku i shkarkimit të tij në vitin 2013. Gjithashtu, denoncimi përmban pretendime për keqmenaxhim të institucionit dhe të personave përgjegjës të emëruar më pas.

Pas shqyrtimit të pretendimeve, KSHPK-ja ka konstatuar se pretendimet e denoncuar nuk janë korrupsion sipas përkufizimit të përcaktuar në Ligjin për Parandalimin e Korrupsionit dhe Konfliktit të Interesit, pas së cilës ka vlerësuar se nuk ka elemente për veprim kompetent në këtë rast.

Duke pasur parasysh të theksuarën më sipër, KSHPK vendosi si në dispozitën e këtij vendimi.

Përgatiti: A.R.M

Miratoi: M.r..SH.S, Anëtar i KSHPK-së

Адреса: ул. Пресвета Богородица број 3, 1000 Скопје - Република Северна Македонија

Адреса: rr. Presveta Bogorodica nr.3, 1000 Shkup - Republika e Maqedonisë së Veriut

email: [contact@dksk.org.mk](mailto:contact@dksk.org.mk)

тел/tel: +389 2 3248 930

<https://www.dksk.mk>

КОМИСИОНИ ШТЕТЁРОРЕ  
ПЁР ПАРАНДАЛИМИН Е КОРРУПСИОНИТ  
Нёнкрыетар  
Mr. Vlladimir Georgiev

